# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-460949**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Besnik Hasi “pushton” Besiktasin, Amedspor merr kreun e Turqisë |
| ADRESA | `https://tpz.al/besnik-hasi-pushton-besiktasin-amedspor-merr-kreun-e-turqise-i333471` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 19:50:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 19:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b38448ae5d85b947e8ce21400867fb197f1cfabe1bb1cdbd0193a533e894bc34` |
| TEKSTI | `216ee73aca975bfab84d62ff1a776f2d3dad12bc2482eebab32a86dc52405ac3` |
| PAMJA | `bef4c52d7d3f62766c40830e41daa2d8a786e8e50f8fa35fb8a6ebda8b7ad2ed` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4da36c6d52379a61027b7e55f73f443a024bcfa6baf644e7b227138a9a1f16a9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d6a36024fef06cd2a7915f3a91ac1ec4390e61f25659ece2cd1751f77a3cac08` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4da36c6d52379a61027b7e55f73f443a024bcfa6baf644e7b227138a9a1f16a9`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT, 20 SEPTEMBER 2026, 21:35

# Besnik Hasi "pushton" Besiktasin, Amedspor merr kreun e Turqisë

tpz.al TPZ



Amedspor ka shënuar një fitore të madhe në Superligën e Turqisë, duke mposhtur Besiktasin me rezultat 3-2 në një ndeshje dramatike të zhvilluar deri në minutat e fundit. Skuadra e drejtuar nga Besnik Hasi vazhdon kështu një start mbresëlënës të sezonit.

Amedspor e ndërtoi avantazhin që në pjesën e parë. Në minutën e 13-të, Gift Orban realizoi një gol spektakolar nga distanca, duke e dërguar topin në këndin e epërm për 1-0. Vetëm në minutën e 22-të, Dia Saba e dyfishoi epërsinë me një goditje të saktë nga brenda zonës.

Besiktasi reagoi pas pushimit dhe në minutën e 55-të ngushtoi rezultatin. Dusan Vlahovic përfitoi nga një top i kthyer dhe shënoi për 2-1, duke e rikthyer skuadrën mysafire në lojë.

Amedspor nuk u zmbraps dhe në minutën e 59-të e riktheu epërsinë prej dy golash. Furkan Soyalp përfitoi nga një gabim në mbrojtjen e Besiktasit, doli në skaj të zonës dhe me një goditje të bukur realizoi për 3-1.

Besiktasi u përpoq të gjente golin e dytë, ndërsa Amedspor mbeti me dhjetë lojtarë pas përjashtimit të Amadou Cisse me karton të kuq në minutën e 84-t. Presioni i skuadrës së madhe turke u rrit në fund dhe pas rishikimit të një rasti për penallti me VAR, Orkun Kokçu realizoi nga pika e bardhë në minutën e 90+8-të për 3-2.

Megjithatë, Amedspor arriti ta mbrojë epërsinë në minutat e fundit dhe mori një nga fitoret më të rëndësishme të sezonit.

Skuadra e Besnik Hasit pas gjashtë xhirove kryeson renditjen me 13 pikë, ndërsa një nga karakteristikat kryesore të saj është edhe fuqia në sulm, me 15 gola të shënuar deri tani.

Në këtë sukses luajtën gjatë gjithë ndeshjes edhe dy futbollistët shqiptarë, Lumbardh Dellova dhe Ermal Krasniqi. Të dy e përfunduan ndeshjen, duke qenë pjesë e rëndësishme e fitores ndaj Besiktasit.

Ndërkohë, Milot Rashica u inkuadrua në minutën e 71-të për Besiktasin dhe pati një paraqitje solide në minutat që qëndroi në fushë. Megjithatë, kontributi i tij nuk mjaftoi që skuadra nga

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Stambolli të shmangte humbjen.

Me këtë fitore, Amedspor po vazhdon të befasojë në elitën e futbollit turk. Nën drejtimin e Besnik Hasit, skuadra nga Diyarbakiri ka marrë një tjetër rezultat të madh dhe po e ndërton sezonin mbi rezultate, gola dhe një sulm që deri tani ka qenë ndër armët kryesore të saj.

Shiko të tjera video

SPORT / 20 September 2026, 21:08

Mourinho i tërbuar me arbitrin, Real Madrid TV shpërthen pas humbjes ndaj Atleticos

SPORT / 20 September 2026, 20:56

Juventusi rikthehet te fitorja, Zhegrova protagonist në suksesin ndaj Atalantës

SPORT / 20 September 2026, 20:39

Egnatia mposht Partizanin në shtëpi, kampionët rikthehen te fitorja

SPORT / 20 September 2026, 19:04

De Rossi nuk i jep minuta Mario Mitajt në Serie A, mbrojtësi i Kombëtares shqiptare asnjë ndeshje me Genoan

SPORT / 20 September 2026, 18:55

Karton të kuq, penallti dhe tre gola, Atletico Madridi fiton derbin e kryeqytetit spanjoll

SPORT / 20 September 2026, 12:15

Arsenal provon “shijen” e humbjes në Premier League, Brighton befason “topçinjtë”, vijon kriza e Tottenham

SPORT / 19 September 2026, 21:05

SPORT / 19 September 2026, 19:54

Dinamo mposht Laçin dhe mban hapin e Teutës, kryeqytetasit ngjiten në vendin e dytë

MotoGP në Spielberg, pas pole position, Jorge Martin fiton edhe Garën Sprint

SPORT / 19 September 2026, 19:27

Tottenham nuk sheh dritë në fund të tunelit, e mund dhe Aston Villa

SPORT / 19 September 2026, 16:39

S'ka qetësi për Anis Mehmetin, pas golit kundër Arsenalit dhe ftesës nga Shqipëria përfundon sërish në tribunë

SPORT / 19 September 2026, 15:29

Lamtumirë Sandro Mazzola! Ndahet nga jeta legjenda e Interit dhe futbollit italian

SPORT / 19 September 2026, 15:07

E nisi tek Interi! Surpriza më e madhe në listë, çfarë zbuloi papritur Maran për risinë e Kombëtares

SPORT / 19 September 2026, 14:27

Mbeti jashtë listës së Maran te Kombëtarja, shfryn Jasir Asani: Më mirë të mos flas, historia nuk harrohet

SPORT / 19 September 2026, 11:46

Maran shpall listën e Kombëtares për Nations League, mungon Broja! Kush janë dy debutuesit e rinj

SPORT / 19 September 2026, 10:13

SPORT / 18 September 2026, 21:29

Futbolli italian në zi, ndahet nga jeta legjenda e Interit

FIFA bën një hap prapa, rikthen Rusinë në garat botërore, do të jetë në Botërorin U-15

SPORT / 18 September 2026, 20:54

Trajneri i ri i Francës, Zidane, zbulon formacionin e ekipit për ndeshjet e Ligës së Kombeve

SPORT / 18 September 2026, 19:50

Probleme për Xhakën, përfundon nën hetim në Zvicër

SPORT / 18 September 2026, 19:04

Rocchi nën hetim për mashtrim sportiv, Prokuroria kërkon arkivimin, ja çfarë zbuluan hetuesit

SPORT / 18 September 2026, 18:07

Revolucion te Holanda, Xavi Hernandez shpall grumbullimin e tij të parë si timonier i "Tulipanëve"

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES NJOFTIME NGA TPZ.AL

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE
SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE

Built & Monetized by Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.